

Republika e Kosovës

Komuna e Vitisë

Republika Kosova

Opstina Vitina

Republic of Kosovo

Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr.03L-040(Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008 lidhur nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit për dhënjën në Shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme Nr.06/L-092 në harmoni me nenin 50 shkrona l të statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491 të dates 21.04.2011, Kryetari I Komunës së Vitisë propozon këtë;

PROPOZIM VENDIM

Formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të ankandit publik për dhënjën e pronës në shfrytëzim afatshkurt dhe afatgjatë

Neni I

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë,formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të ankandit public për dhënjën e pronës në shfrytëzim afatshkurt dhe afatgjatë në Komunën e Vitisë

Neni II

Detyrat dhe Përgjegjësit e Komisionit të Ankesave janë:

Shqyrtimi i të gjitha ankesave të paraqitura

Kthimi i pergjigjeve brenda afatit ligjor dhe
Raportimi

Neni III

Kryetari i Komunës i propozon dy anatarë nga ekzekutivi i Komunës, Kuvendi i Komunës i propozon dy antarë nga Kuvendi i Komunës dhe një antarë nga subjektet politike

Neni IV

Komisioni ka këtë përbërje:

- 1.-----Kryetar
- 2.-----Antarë
- 3.-----Antarë
- 4.-----Antarë
- 5.-----Antarë

Neni V

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Më dt.14.10.2020

Propozues, Kryetari i Komunës së Vitisë

Sokol Haliti





15-10-2020
02-035/02-994

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr.28/2008 dhe neni 6 paragrafi 1, pika 1.1, neni 8 paragrafi 1 pika 1.3, të Ligjit me nr. 06/L-092, Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës dhe neni 50 paragrafi 1 shkronja I, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi me datën 14.10.2020, bën këtë :

PROPOZIM VENDIM

Për dhënjën në shfrytëzim të Pronës Komunale NPSH „ARENA SPORT“ Në Kabash.

Neni 1

Me këtë propozim – vendim, propozohet dhënja në shfrytëzim e pronës së palujtshme të Komunës së Vitisë, NPSH „Arena Sport“ në Kabash e rexhistruar me numer biznesit 70396085.

Neni 2.

Prona e palujtshme e propozuar për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale e cekur në piken 1 të këtij propozimi është :

- Parcela kadastrale me nr. P -70101025-01374-2, lloji i njësisë : parcelë, zona : rurale, sipërfaqja 3857 m², vendi i quajtur: Seferin, kultura kullosë e klasit 5, pronë e P.Sh. Kuvendi i Komunës Viti, zonën kadastrale në Kabash..
- Parcela kadastrale me nr. P -70101025-01375-2, lloji i njësisë : parcelë, zona : rurale, sipërfaqja 36143 m², vendi i quajtur: Seferin, kultura kullosë e klasit 4, pronë e P.Sh. Kuvendi i Komunës Viti, zonën kadastrale në Kabash.

Neni 3.

Qellimi i dhënjes në shfrytëzim të pronës së palujtshme të Komunës të cekur në nenin 2 të këtij propozimi është ushtrimi i veprimtarisë për aktivitetet sportive dhe rekreacion (hotel, restora, kafiteri, fusha të sportit për futboll, voljeboll dhe basketboll, shtigje për vrapime të lira në natyrë si dhe çdo aktivitet tjetër rekreacioni dhe sportiv).

Neni 4.

Ky propozim vendim për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale është në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal nr.01-013/126 të datës 07.02.2011 për zhvillimin e sportit dhe rekreacionit si dhe turizmit rural.

Neni 5.

Afati kohor për dhënjën e pronës së palujtshme të Komunës të cekur në piken 2 të këtij propozim vendimi është afat shkurtur në periudhën deri 15 vite.

Neni 6.

Procedurat për dhënjën e pronës së palujtshme të Komunës në shfrytëzim afat shkurtër është në pajtim me neni 11 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06/L-092, meqen se vlera e investimeve në rregullimin e arenes sportive pritet të jetë 230,000.00 € me qka tejkalohet vlera prej 10 % e buxhetit të përgjithshme për investime kapitale të komunës gjatë vitit paraprak. (Investimet kapitale komunale për vitin 2019 kanë qenë 2,123,287.00 €, kurse 10 % e kësaj vlere është 212,328.70 €).

Neni 7.

Menyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së palujtshme do të përcaktohen me kontratë e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfitusiti marrjes në shfrytëzim të pronës së palujtshme në periudhë afatshkurtër, me të drejt shkeputjesë së kontratës edhe para afatit nese prona e dhënë në shfrytëzim nuk shfrytëzohet për qëllimie të cekura në nenin 3 të këtij vendimi.

8.

Për zbatimin e këtij propozim – vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës , Drejtoria për Urbanizem, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi të komunës së Vitisë.

9.

Neni .

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

A r s y e t i m

Kuvendi Komunal i Vitisë me Kontratë Koncesioni 01-016/1679, të datës 13.04.2007, NPSH "ARENA-SPORT" ia ka dhënë në shfrytëzim sipërfaqen e përgjithshme prej 40000m² për periudhen 10 vjeqare pjesët e parcelës kadastrale 1374 dhe pjesen të parcelës kadastrale 1375 në vendin e quajtur : Seferin, në zonën kadastrale në Kabash. Sipas kësaj Kontrate të Koncesionit ka qenë që NPSH "ARENA-SPORT" të zhvilloj aktivitete në vijim : restoran, fushë për futboll të vogël, fushen e basketbollit, fushen e voljebollit, shtigje për vrapim , shtigje për vrapim të gjatë (Olimpik) dhe qfardo aktiviteti tjetër rekracion dhe sportive.

Për zhvillimi e suksesshem të këtyre aktiviteteve rekracioni dhe sportive NSHP "ARENA-SPORT ka paraqitur Plan Biznesin Strategjik NRB:70396085, për këtë periudhe që do ti jepet në shfrytëzim. Kërkesa e NPSH "ARENA-SPORT" për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale për periudhen bazohet në vleren e investimeve të tanishme si dhe investime e planifikuara në të ardhmen, gjithashtu kjo kërkesë bazohet në nenin 11 të të Ligjit me nr. 06/L-092 , Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës, pa zhvilluar procedura paraprake duke i ofruar ofertën komunës për investimet e vlerës së paku 10% të bugetit të përgjithshmem për investime kapitale të Komunës nga viti paraprak; gjithashtu për këtë pronë nuk ka pasur interesim për marrjen në shfrytëzim nga pala e tret së paku 3 vitet e fundit.

Nga të cekurat si më lartë u vendos si në këtë propozim.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSHINA VITINE
Data: 11.09.2020
Nr. i dokumentit: 07-070/01-855
Lloji i dokumentit: Vlerësim
Vendi: Viti
Shprehja: Vlerësim



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipal Vitina

Për: Drejtorin e Kadastrit, Pronës dhe Gjeodezisë në Viti:

z.Majlinda Ostorgllava

Nga: Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit-

sektori i Planifikimit Viti

Lënda: Informatë Urbanistike për dhënien e lokacionit në shfrytëzim

Në bazë të kërkesës nr.07-070/01-850 të datës 10.09.2020 nga Drejtoria e Kadastrit ,Pronës dhe Gjeodezisë në Viti e cila kërkon nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit përkatësisht nga sektori i planifikimit hapësinorë, të informohet për parcelat : 1374-2 me sipërfaqe 3857 m² dhe parcela 1375-2 me sipërfaqe 36143m². Se a janë në harmoni me planin zhvillimor Komunal.

Pas shqyrtimit të kërkesës nr.07-070/01-850 të datës 10.09.2020 nga Drejtoria e Kadastrit ,Pronës dhe Gjeodezisë në Viti e cila kërkon nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit përkatësisht nga sektori i planifikimit hapësinorë, që të informohet për parcelat e latë shënuara.

Vertetojm se parcelat : 1374-2 me sipërfaqe 3857 m² dhe parcela 1375-2 me sipërfaqe 36143m² z.k .Kabash janë në harmoni të plot me Planin Zhvillimor Komunal nr . 01-013/126 të datës 07.02.2011 për zhvillimin e sportit dhe rekreacionit si dhe turizmit rural.

Me 11.09.2020

Përgjegjës i sektorit të Planifikimit:

Ida. Xhevdet Halili

Drejtori:

Ajet Sallahu



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLICA E KOSOVES
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

04.09.2007

02-326/04-28663

Për : Kryetarin e Komunës së Vitisë, z. Sokol Haliti dhe Kuvendin Komunal në Viti.

Nga: NPSH " ARENA -SPORT" në Kabash, përfaqësuar nga Adem Zeqiri

Lënda : Kërkesë për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale në zonën kadastrale në Kabash për ngastrat kadastrale me nr.1374-2 dhe ngastren kadastrale me nr.1375-2,.

Kërkoj nga Kryetari i Komunës së Vitisë, z. Sokol Haliti dhe Kuvendin Komunal në Viti që të me jepet në shfrytëzim prona e palujtshme komunale e cila gjindet në zonën kadastrale në Kabash konkretisht ngastrat kadastrale me nr.1374-2, me sipërfaqe prej 36143m² dhe ngastrat kadastrale me nr.1375-2, me sipërfaqe prej 3857m². Kërkesën për marrjen në shfrytëzim të pronës së palujtshme komunale e paraqesë duke u bazuar në Ligjit me nr. 06/L-092 , Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës.

Siç jeni në dijeni NPSH „ARENA-SPORT“ në Kabash me çartifikaten e biznesit 70396085 me përfaqësues Adem Zeqirin kemi pasur të lidhur një kontratë koncesioni me nr.01-016/1679, të datës 13.04.2007 në mes Kryetarit të Kuvendin Komunal në Viti z. Musa Misini dhe përfaqësuesit të NPSH „ARENA – SPORT“ z. Adem Zeqiri, e që më është dhënë në shfrytëzim sipërfaqen e përgjithshme prej 40000m² për periudhën 10 vjeqare pjesët e parcelës kadastrale 1374 dhe pjesën të parcelës kadastrale 1375 në vendin e quajtur : Seferin, në zonën kadastrale në Kabash. Sipas kësaj Kontrate të Koncesionit NPSH „ARENA-SPORT“ për zhvillimin e kësaj veprimtarie kemi pasur për obligim të zhvilloj aktivitete në vijim : restoran, fushë për futboll të vogël, fushën e basketbollit, fushën e voljebollit, shtigje për vrapim , shtigje për vrapim të gjatë (Olimpik) dhe qfardo aktiviteti tjetër rekreacion dhe sportive.

Gjatë kësaj periudhe 10 vjeqare NPSH „Arena-Sport “ në Kabash i kemi përmbushur të gjitha obligimet që kemi marre për sipër sipas kontratës së lartcekur ku kemi edhe Informaten e Drejtorisë së Financave në Viti.

Pas përfundimi të afatit 10 vjeqar të kontratës koncesionare gjatë kësaj periudhe me sukses kemi zhvilluar të gjitha aktivitetet të cilat kane qenë të cekura në kontratë . Pasi jemi të interesuar ta zhvillojme këtë veprimtari dhe mos ta nderpresim ne kemi me heret paraqitur kërkesa për vazhdim të kontratës sipas nenit 2 paragrafi 2, të kontratës koncesionit, por nuk na është mundsuar për shkak të ligjeve që janë nxjerrur nga Kuvendi i Kosovës mbi dhenjen në shfrytëzim të pronës palujtshme komunale e që duhet të zhvillohet procedura tjera. Andaj kemi paraqitur kërkesë që të na jepet në shfrytëzim sipas Ligjeve që është në fuqi d.m.th sipas Ligjit me nr. 06/L-092 , Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës

Për zhvillimi e suksesshem të këtyre aktiviteteve rekreacioni dhe sportive NSHP "ARENA-SPORT" përfaqshuar nga Adem Zeqiri kemi paraqitur Plan Biznesin Strategjik NRB:70396085, për këtë periudhe që do ta marrim në shfrytëzim. Kërkesa e jonë (NPSH "ARENA-SPORT") për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale për periudhen e ardhshme kohore bazohet në vlerën e investimeve që do të behen si dhe investime e planifikuara në të ardhmen sipas Plan Biznesin Strategjik, gjithashtu kjo kërkesë bazohet në nenin 11 të të Ligjit me nr. 06/L-092 , Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës, pa zhvilluar procedura paraprake duke i ofruar ofertën komunës për investimet e vlerës së paku 10% të bugjetit të përgjithshmem për investime kapitale të Komunës nga viti paraprak.

Të bashkangjitur keni:

- Kopja e kontratës me NR.protokolit 01-016/1679, të datës 13.04.2007.
- Kërkesa e parë me Nr.të protokolit 06-320/04-20918, të datës 24.05.2017
- Kërkesa e dytë me Nr.protokolit 02-320/04-33620, të datë 14.08.2017 dhe
- Plan Biznesin Strategjik NRB:70396085.

Me respekt !

Parashtruesi i kërkesë :
Adem Zeqiri, përfaqësues i "Arena-Sport"
nga fsh. Kabash, komuna e Vitisë
Viti, me datën, Adem Zeqiri

1005463817



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70101025-01375-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

3097/2020

he koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

13.10.2020 - 13:17

Opština / Municipality:

Viti / Vitina / Viti

Kadastrale / Katastrarska Zona / Cadastral Zone:

KABASH / KABAŠ / KABASH

Kadastrale Komunale / Opštinska Katastrarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: Viti / Vitina / Viti

DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTRARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastrarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70101025-01375-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	/ /	Rural	3857	ne baze te vendimit se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nr.07/1904/2 dt.03.07.2008 ne baz dhenjes te vendimit te tokes ne shfryzrim me koncesion nr 01-13/695 dt 23.01.2007		

ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTRARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojedinsti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
SEFERIN/SEFERIN/SEFERIN		SEFERIN		

LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE



Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Kullosat/Pashnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 4/Pashnjak 4 Klase/4th Class Pasture	3857

RONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinositi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Individual / Fizikalna Drzavina / Possessor	KOMUNA VITISË	90006819.	VITI / VITINA / VITI /		ADEM JASHARI	1/1	ne baze te aktivndimit nr.437/2020	07.10.2020



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70101025-01374-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 3097/2020
Koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 13.10.2020 - 13:16
Komuna / Opština / Municipality: Viti / Vitina / Viti
Kadastrale Komuna / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: KABASH / KABAŠ / KABASH
Kadastrale Zona / Cadastral Zone: Viti / Vitina / Viti

UDHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTRARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70101025-01374-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	/ /	Rural	36143	ne baze te vendimit se Miisria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor nr.07/1904/2 dt.03.07.2008 ne baz dhenjes te vendimit te tokes ne shfryzim me koncesion nr 01-13/695 dt 23.01.2007		

ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTRARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
SEFERIN/SEFERIN/SEFERIN		SEFERIN		

LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²)
Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Kullosat/Pashnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 5/Pashnjak 5 Klase/5th Class Pasture	36143

PRONARI/POSEDEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinositi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Individual / Lична Državina / Possessor	KOMUNA VITIŠE	90006819.	VITI / VITINA / VITI /		ADEM JASHARI	1/1	ne baze te aktivendimit nr.437/2020	07.10.2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA			
13.10.2022			
Nat. Organi	Nat. Organi	Nat. Organi	Nat. Organi
Org. broj	Nat. Organi	Nat. Organi	Nat. Organi
02-035/02-980		Vlera Vrednos	

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na


Në bazë të nenit 58 pika h Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, neni 6 nën paragrafi 2.1 të Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim nderkomunal dhe nenit 5 nën paragrafit 1.1 i Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Nderkomunal, nenit 50 shkronja L të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

NISMË

PËR NXITJEN E BASHKËPUNIMIT NDËR-KOMUNAL E KRYETARIT TË KOMUNES SË VITISË ME KOMUNAT E REPUBLIKES SË KOSOVËS NË FUSHAT E PËRGJITHSHME SI INFRASTRUKTUR RRUGORE, EKONOMI, BUJQESI, ETJ.


1. Bashkëpunimi ndër-komunal do të zhvillohet me Komunat e Republikës së Kosovës.
2. **Qëllimi i bashkëpunimit**- bashkëpunimi do të bëhet në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.
3. **Bashkangjitur** me nismë do të paraqesim mendimin me shkrim dhe të arsyetuar dhe vendimin për miratimin e nismës nga Kuvendit i Komunës së Vitisë, me të cilin vendim për miratim të nismës do të njoftohet kryetari i komunës me të cilët tentojmë të kemi bashkëpunim.
4. **Arsyetim**- Komuna e Vitisë dhe komunat e Republikës së Kosovës kanë shprehur paraprakisht vullnetin e tyre për bashkëpunim dhe janë pajtuar që përmes zyrave të projekteve përkatëse të komunave të bashkëpunojnë në sferën e infrastrukturës së përgjithshme në projekte me interes të përbashkët në infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi etj, që do të lidh komunat mes veti. Ndërtimi i bashkëpunimit do të lidhë fshatrat e kësaj treve dhe lehtëson që popullata lokale e kësaj treve të komunikojnë me lehtë me qendrat komunale.

Propozues:





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, neni 6 pika 2.1 të Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim nder-komunal dhe nenit 5 pila 1.1 i Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Nder-komunal, nenit 50 shkronja I të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë

PROPOZIM VENDIM PËR NISMËN

E KRYETARIT TË KOMUNES SË VITISË PËR NXITJEN E BASHKËPUNIMIT NDËR-KOMUNAL ME KOMUNAT E REPUBLIKES SE KOSOVES NË FUSHAT E PËRGJITHSHME SI INFRASTRUKTUR RRUGORE, EKONOMI, BUJQESI, ETJ.

Neni I

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal të Vitisë të miraton nismën për bashkëpunimin nder-komunal me Komunat e Republikës se Kosovës në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.

Neni II

Bashkëpunimi nder-komunal do të zhvillohet me komunat e Republikës se Kosovës.

Neni III

Detajet e bashkëpunimit do te përcaktohen me marrëveshje të bashkëpunimit.

Neni IV

Ky propozim vendim prodhon efekt juridike deri në përfundim të mandatit të Kryetarit të Komunës së Vitisë.

Neni V

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues:

Kryetari i Komunës, Sokol Haliti





- Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, neni 6 pika 2.1 të Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim nder-komunal dhe nenit 5 pila 1.1 i Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Nder-komunal, nenit 50 shkronja I të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë

**PROPOZIM VENDIM PËR NISMËN
E KRYETARIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR BASHKËPUNIM NDËR-KOMUNAL ME KOMUNAT E
REPUBLIKES SË KOSOVËS NË FUSHAT E PËRGJITHSHME SI INFRASTRUKTUR RRUGORE,
EKONOMI, BUJQESI, ETJ.**

Neni I

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal të Vitisë të miraton propozim vendimin për AUTORIZIMIN e Kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunitet e Republikës së Kosovës për bashkëpunimin nder-komunal në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.

Neni II

Pas marrjes së autorizimit Kryetari i Komunës së Vitisë e njofton Kryetarin e Komunës përkatëse për nismën me të cilin kërkohet themelimin e bashkëpunimit nder-komunal.

Neni III

Ky propozim vendim prodhon efekt juridike deri në përfundim të mandatit të Kryetarit të Komunës së Vitisë.

Neni IV

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues:



Kryetari i Komunës, Sokol Haliti



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitia

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA			
Pranuar - Prilapjenia Mediana 14.10.2020			
Nr./ organit Org.broj	Numri/Identi Prilap	Udhëzues Vlerë	Vendosje Vendosje
02-016/01-919			

INFORMATË PËR RAPORTIN E PERFORMANCËS PER VITIN 2019 TË KOMUNËS SË VITISË

Viti, 14.10.2020



Kryetari i Komunës
Sokol HALITI


Raporti i performancës për vitin 2019 KOMUNA E VITISË

Përmbledhje e përgjithshme

Performanca e përgjithshme e komunës në 19 fusha të matjes është 62.57. Fusha me performancën më të lartë është në fushën e Menaxhimit të Fatkeqësive me 97.92%, derisa fusha me performancën më të ulët është Parkingjet publike me 34.45%. Performancë e lartë është treguar edhe në fushën e Transparencës Komunale me vlerën prej 93.57%, Kulturë, Rini dhe Sport me 93.53%, teksa fushat për të cilat duhet t'iu jepen prioritet janë: Planifikimi Hapësinor 37.22%, Uji i pijshëm 39.15%, Kanalizimi 38.53% si dhe fushave të tjera me performancë jo të kënaqshme. Sa u përket treguesëve, performanca e përgjithshme është 62.83%.

Në vijim është paraqitur performanca në nivel të fushave:

Performanca sipas fushave



PERFORMANCA SIPAS FUSHAVE

Fusha 1. Shërbimet Administrative

Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 89.98%. Komuna e Vitisë ofron shërbime përmes e-kioskut. Performanca e arritur në treguesit për shërbime elektronike është 70%. Gjatë periudhës së vitit 2019, Komuna ka pranuar dhe shqyrtuar gjithsej 64,518 kërkesa, prej të cilave 99.97% të shqyrtuara brenda afatit ligjor.

Fusha 2. Transparenca komunale

Performanca e përgjithshme në fushën e transparencës është 93.57%. Në nivel të treguesve, komuna ka pasur performancë të plotë në publikimin njoftimeve dhe procesverbaleve për mbledhje të kuvendit, si dhe transmetim online të tyre. Performancë e plotë është raportuar edhe në publikimin e akteve të miratuara nga kuvendi i komunës dhe akteve të kryetarit të komunës. Po ashtu, janë publikuar dokumentet për planifikim dhe shpenzim të buxhetit. Performancë prej 80% është treguar në publikimin e dokumenteve të prokurimit publik dhe kontratave të nënshkruara. Niveli i qasjes në dokumentet publike nga qytetarët është 98.25%, apo në 56 nga 57 kërkesat e parashtuara, është lejuar qasje sipas kërkesës. Sa i përket përbushjes së kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës, komuna ka përbushur këto kriterë në shkallën 87.50%.

Fusha 3. Përgjegjshmëria komunale

Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 74.81%. Komuna ka bërë publike njoftimet për mbajtjen e dy takimeve në pajtim me kriteret përkatëse. Në faqen e internetit figurojnë publikimet për dëgjimet publike të komunës për vitin 2019. Pjesëmarrja e qytetarëve në takimet publike ka arritur vlerën prej 42.53%, e cila është e vlerë mesatare sipas parametrin referent (3% e popullatës). Në bazë të deklaratimit dhe verifikimit në ueb-faqen e komunës dhe raportin e transparencës, janë konsultuar 9 akte para miratimit në kuvendin e komunës, duke rezultuar me performancë të plotë. Gjithashtu, komuna ka mbajtur 15 diskutime buxhetore konform rregullave ligjore duke plotësuar dhe standardin e matjes për së paku një takim për 10.000 banorë, si dhe ka publikuar procesverbalet në faqen e internetit për dëgjimet buxhetore. Komuna nuk ka hartuar raportet e konsultimeve publike sikurse kërkohet me Udhëzimin për Standardet Minimale të Konsultimit Publik. Komuna e Vitisë ka të themeluar 36 këshilla lokale në raport me 39 vendbanime, prej të cilave 36 këshilla kanë mbajtur së paku gjashtë takime brenda vitit, duke reflektuar kështu performancën prej 92.31%. Në kuadër të procedurave të aprovimit të buxhetit komunal, komuna nuk e ka dorëzuar me kohë propozimbuxhetin në kuvend të komunës, megjithëse ishte aprovuar para datës 30 Shtator, duke rezultuar në performancë prej 70%. Komuna ka mbajtur diskutimet buxhetore tremujore për buxhetin komunal, duke rezultuar me performancë të plotë apo 100%. Sipas të dhënave, kuvendi i komunës nuk e ka paraqitur për diskutim raportin e performancës të vitit 2018. Lidhur me sigurimin e llogaridhënies nga kuvendi i komunës, komuna diskutuar në kuvend raportin e auditorit të jashtëm, por jo edhe planin e veprimit gjë që ka reflektuar në performancën prej 50%. Të dhënat tregojnë për prezencën e kryetarit në mbledhjet e mbajtura të kuvendit të komunës, përkatësisht në 9 prej 13 mbledhjeve të kuvendit, apo 69.23% në këtë tregues. Niveli i zbatimit të planit të prokurimit është raportuar prej 59.83%, kurse ka përbushur 85.91% të pagesave brenda afatit ligjor prej 30 ditëve. Në kuadër të masave antikorrupsion Komuna e Vitisë ka raportuar të ketë hartuar dhe diskutuar planin e integritetit. Në këtë komunë nuk ka pasur të raportuar për zyrtarë të akuzuar nga organet e drejtësisë për shpërdorim të detyrës zyrtare. Menaxhimi i burimeve njerëzore shënon performancë prej 76.84% sa i përket shpërndarjes së vlerësimeve për zyrtarët publik sipas ligjit, apo janë vlerësuar 136 prej 177 punëtorëve në administratën komunale. Po ashtu është raportuar se 12 vendeve të punës janë proceduar përmes SIMBNj-së, me rezultat të plotë të performancës. Përkitazi me menaxhimin e kontratave për shërbime të veçanta, komuna ka raportuar se 26 prej zyrtarëve me shërbime të veçanta apo 100% janë bërë në përputhje me kërkesat ligjore. Zbatimi i rekomandimeve të ZKA është arritur në shkallën prej 37.50%¹.

¹ <http://www.zka-rks.org/ep-content/uploads/2019/07/Analiz%C3%AB-Tregues-t%C3%AB-performanc%C3%AB-p%C3%AB-nivelin-lokal-qeveris%C3%ABs-2018.pdf>

Fusha 4: Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familiare

Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 59.84%. Komuna e Vitisë nuk ka të punësuar persona me nevoja të veçanta, ndërsa gjithsej ka 1164 punonjës në administratën dhe institucionet komunale. Në bazë të të dhënave të ASK-së, Komuna e Vitisë ka gjithsej 46,987 banorë prej të cilëve 46,669 shqiptarë, dhe 275 banorë nga komunitetet tjera. Përfshirja e të punësuarve nga komunitetet jo-shumicë është në vlerën 59.38% apo gjithsej 4 të punësuar nga të cilët 1 grua. Komuna ka siguruar banim social për 24 familje në nevojë apo 80% të kërkesave të realizuara, pa asnjë rast të përfundimit të banimit social. Po ashtu, ka siguruar edhe 1 rast të strehimit të fëmijëve në nevojë në familjet strehuese, duke performuar 100% në këtë tregues.

Fusha 5. Kulturë, Rini dhe Sport

Performanca e kësaj fushe është 93.53%. Komuna ka gjithsej në menaxhim 41,820 m² hapësira sportive, me shtesën e 600 m² gjatë vitit raportues, dhe performancë prej 87.05% në raport me vlerën referente të popullsisë. Komuna ka mbështetur gjithsej 171 aktivitete kulturore, rinore dhe sportive duke përbushur me 100% të standardit të kërkuar në raport me numrin e popullsisë. 100% është realizuar performanca për pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitete kulturore, rinore dhe sportive apo 36,693 pjesëmarrës.

Fusha 6. Menaxhimi i Fatkeqësive Natyrore

Përqindja totale e arritur në këtë fushë është 97.92%. Niveli i përgjithshëm i realizimit të Planit Komunal për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore dhe të tjera është konstatuar të jetë 95.83%, ashtu që nga 24 veprime të parapara në këtë plan janë realizuar 23. Në komunën e Vitisë janë raportuar 346 fatkeqësi gjatë vitit 2019, për të cilat kishin intervenuar njësitë përgjegjëse komunale, duke rezultuar me performancë të plotë.

Fusha 7. Planifikimi Hapësinor

Performanca e arritur në nivel të fushës për vitin e raportuar është 37.22%. Komuna e Vitisë ka një territor prej 270 km² apo 27,000 ha, prej tyre 212 ha janë të mbuluara me plane rregulluese të hollësishme, apo 0.79%. Komuna ka regjistruar gjithsej 23 kërkesa për leje ndërtimore, prej të cilave janë shqyrtuar 22, apo 95.65%. Komuna ka inspektuar 100% të objekteve të reja të ndërtuara gjatë vitit të raportimit. Prej 75 objekteve të reja, të gjitha janë inspektuar, ku me leje kanë rezultuar 19 ndërtime, duke reflektuar në 25.33% të performancës.

Fusha 8: Hapësirat publike

Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 51.58%. Komuna e Vitisë ka deklaruar 12.2 hektarë sipërfaqe publike për qytetarë, prej të cilave 9.8 ha mirëmbahen rregullisht, apo 80.33%. Treguesi për ndriçimin publik të hapësirave publike, tregon se 37 prej 50 hapësirave publike janë të pajisura me sistem të ndriçimit, apo 74%.

Fusha 9. Infrastruktura Rrugore

Performanca e arritur është 56.95%. Analiza e të dhënave të raportuara tregon se Komuna e Vitisë ka gjithsej 241.24 km rrugë lokale, prej të cilave të asfaltuara janë 185 km, prej tyre 18 km të asfaltuara në vitin e raportimit, duke arritur performancë prej 77.66% të treguesit. Mirëmbajtja është në nivel të njëjtë gjatë sezonës së dimrit dhe verës, me 66.32%. Ndriçimi publik është i shtrirë përgjatë 162.99 km rrugë lokale prej 241.24 km, duke rezultuar me performancë prej 52.64%. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal për komunikacion publik është i raportuar të jetë i shtrirë në 66.32% të rrjetit rrugor prej 160

km, përkatësisht korrespondon me gjatësinë e rrugëve të asfaltuara. Nuk është raportuar të ketë shtigje për biçikleta.

Fusha 10. Transporti Publik

Në fushën e Transportit Publik komuna e Vitisë ka treguar nivel të performancës prej 84.62%. Komuna e Vitisë në vitin 2016 ka zhvilluar planin e mobilitetit i cili shërben si dokument për organizimin e transportit publik. Plani i veprimeve për transportin publik komunal ka paraparë 1 aktivitet, i përmbushur plotësisht. Tek treguesi për përfshirjen e vendbanimeve në ofrimin e transportit publik është deklaruar për 21 prej 39 vendbanimeve në nivel të komunës, apo performancë në shkallë prej 53.85%. është raportuar për 30 vendndalime të shenjëzuara, apo 100%.

Fusha 11. Parkingjet Publike

Fusha e parkingjeve publike shënon rezultat prej 34.45%. Numri i parkingjeve publike në komunë ka mbetur i pandryshuar krahasuar me vitin paraprak, me gjithsej 6 parkingje. Treguesi për vendparkime shënon performancë me 4.02% krahasuar me numrin e automjeteve të regjistruara në komunë. Po ashtu edhe numri i parkingjeve me vende të rezervuara për persona me nevoja të veçanta nuk ka pasur ndryshime me vitin paraprak, me 33.33% të performancës, apo 2 prej 6 parkingjeve. Totali i makinave të licencuara për taksì korrespondojnë me vendparkimeve të rezervuara për taksì, me rezultat të performancës me 66%.

Fusha 12. Uji i Pijshëm

Në këtë fushë komuna ka treguar performancë prej 39.15%. Komuna ka kryer 1 nga 4 aktivitetet e planifikuara në fushën e ujit të pijshëm për vitin e raportuar apo 25.00%. Me ujësjellës publik shërbehen 7,013 amvisëri, institucionet publike dhe 9634 biznese sa janë në nivel të komunës, apo 53.29%.

Fusha 13. Kanalizimi

Fusha e kanalizimit shënon performancë prej 38.53%. Komuna ka kryer 1 nga aktivitetet e planifikuara në fushën e kanalizimit për vitin e raportuar. Në rrjetin e kanalizimit publik janë të përfshira 6,936 amvisëri prej 7,519 sa janë gjithsej, 33 prej 56 institucioneve publike, si dhe 220 prej 2,059 bizneseve, apo 54.12%.

Fusha 14. Menaxhimi i Mbeturinave

Në fushën e menaxhimit të mbeturinave performanca është arritur në 39.93%. Komuna e Vitisë ka raportuar se nuk ka plan për menaxhimin e mbeturinave. Përfshirja në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave ofrohet për 3283 ekonomi familjare, prej 7,519, 49 sa janë gjithsej. Po ashtu me këtë shërbim mbulohen 56 institucioneve publike dhe 356 biznese prej 2,059 në nivel të komunës, duke rezultuar me performancë prej 49.48%. Shkalla e zbatimit të orarit të grumbullimit të mbeturinave shkon në 95.16%. Shkalla e inkasimit të faturimit arrin vlerën prej 87.12%. Shkalla e deponimit të mbeturinave për kokë banori është raportuar në vlerën prej 3.90 kg në vit. Vlerësimi bëhet kundër një mesatare standarde minimale të mbeturinave të deponuara në Bashkim Evropian (BE) që është 492 kg mbeturina të gjeneruara për person në vit². Andaj deponimi i mbeturinave në këtë nivel për person në komunë konsiderohet vlerësim minimal.

² https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Municipal_waste_statistics

Fusha 15. Mbrojtja e Mjedisit

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit Komuna e Vitisë ka shënuar performancë prej 85%. Komuna ka zbatuar 3 prej 4 veprimeve të planifikuara në fushën e mjedisit, apo 75%, kurse ka lëshuar 13 leje mjedisore prej 13 kërkesave të pranuar, duke arritur performancë prej 100%. Sipas të dhënave prej 13 objekteve të reja të cilave iu kërkohet leja mjedisore, të gjitha janë pajisur me këto leje, ndërsa nuk ka pasur asnjë fletëparaqitje në gjykatë për mosposedimin apo zbatim të lejes mjedisore komunale.

Fusha 16. Përfaqësimi Gjinor

Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 47.41%. Performanca e barazisë gjinore në treguesin për regjistrimin e pronësisë në emër të dy gjinive është 5.87%. Emërtimi i rrugëve në emër të personave të gjinisë femërore është 7.53%, teksa barazia gjinore e përbërjes së këshillave lokale është 7.47%. Performancë më e lartë në këtë fushë është raportuar te shkalla e punësimit në institucionet komunale, 88.14%, apo 513 gra prej totalit 1164 të të punësuarve në institucionet e nivelit komunal. Përfshirja e grave në pozita udhëheqëse në komunë është 65.63%. Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor është raportuar të jetë përmbushur nga komuna, si dhe raportimi për shpenzimin e buxhetit sipas kategorive gjinore, duke rezultuar me performancë të plotë. Përfaqësimi në nivel politik është raportuar me 33%, 3 prej 10 pozitave (apo 60% e kriterit 50x50), kurse 80% i këtij kriteri tek anëtarët e komiteteve komunale. Tek treguesi barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave, është 100%. Komuna e Vitisë ka ndarë € 72,000 buxhet për skemën e punësimit dhe ndërmarrësisë, subvencione në bujqësi dhe zhvillim ekonomik, prej të cilave € 41,160 janë ndarë për gra dhe vajza, ku kanë qenë 72 gra dhe vajza. Pjesëmarrja e grave në takime publike është raportuar me 51.13%.

Fusha 17. Arsimi Parauniversitar

Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 48.08%. Dy treguesit me performancë më të dobët janë ai për çerdhe apo kopshte në vendbanime rurale 0% (nuk ka çerdhe apo kopshte në vendbanime rurale), dhe treguesi për shkallën e plotësimit të buxhetit të arsimit me të hyra vetanake, 0.77%. Raporti i sipërfaqeve shkollore me numrin e nxënësve në vendbanime rurale është raportuar me 5.1 m² për kokë nxënësi. Treguesi m² të hapësirave për nxënësi llogaritet në proporcion me vlerën më të madhe të këtij treguesi në nivel të Kosovës. Si rezultat i kësaj llogaritjeje performanca në këtë tregues ka arritur 89.03%. Aspektet e infrastrukturës shkollore tregojnë se pajisja me kabinet të internetit është 52.63% apo 20 prej 38 shkollave, shkolla me masa të eficiencës së energjisë 52.63% apo 20 prej 38 shkollave, plotësimi me kushtet e kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucione shkollore 29.41% apo mesatarisht 11 prej 38 shkollave i plotësojnë kriteret infrastrukture dhe pajisjeve, por asnjëra nuk kanë raport nga inspektorati higjienik-sanitar komunal. Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar ka shënuar performancë prej 63.16%, duke raportuar se prej 38 shkollave, 20 janë të pajisura me rrethoja dhe kamera, si dhe 21 prej tyre kanë dorëzuar raportin obligativ përmbljedhës 2 herë në vit, e po ashtu edhe KKSBJ-ja ka raportuar 3 herë para kuvendit komunal. Sipas të dhënave 722 mësimdhënës janë raportuar të jenë të pajisur me licencë prej 811 në përgjithësi, duke shfaqur një rezultat prej 89.03%. Komuna e Vitisë po ashtu ka një rezultat të mirë tek përmbushja e raportit të synuar për 26 nxënës për 1 mësimdhënës, 64.87% në zonat urbane, dhe 59% në zonat rurale. Komuna e Vitisë ka punësuar 31 mësimdhënës të rinj përmes afatit të rregullt gjatë vitit 2019, duke zbatuar të gjitha kriteret e udhëzimit administrativ, dhe kështu ka arritur rezultat prej 100% te treguesi. Kurse në afat plotësues ka punësuar 14 mësimdhënës duke respektuar kriteret e udhëzimit administrativ për shpalljen e konkursit, formimin e komisionit, zbatimin e kriterëve për vlerësimin e aplikacioneve, njoftimin për rezultat dhe kontraktimin e tyre. Nuk ka pasur procedurë për punësimin e drejtorëve apo

zv. drejtorëve të shkollave, prandaj rezultati i performancës mbetet me 100%. Rezultati i testit të arritshmërisë për klasët e 9 është 64%, ku ajo për vajza është pa dallim, që është një indikacion i barazisë së hershme. Kalueshmëria e nxënësve në provim të maturës, është afër mesatares së vendit, me 57.52%. Vijueshmëria apo e kundërta shkalla inverse e braktisjes është raportuar me performancë të plotë. Kurse zbatimi i orarit mësimor, përkatësisht shkalla e realizimit të orëve të planifikuara rezulton me performancë prej 92.82%.

Fusha 18. Kujdesi Primar Shëndetësor

Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 55.56%, ku performancë më e ulët është raportuar tek treguesi për shkallën e plotësimi të buxhetit të shëndetësisë me të hyra vetanake, 4.04%. Raporti i sipërfaqeve të përgjithshme të hapësirave të kujdesit primar shëndetësor në komunën e Vitisë për 10,000 banorë është 1,131m². Përqindja e këtij treguesi llogaritet në proporcion me vlerën më të madhe të këtij treguesi në nivel të Kosovës dhe performanca e komunës arrin vlerën 88.38%. Raportimi i përmbushjes së kriterëve për mjete, pajisje mjekësore dhe shërbime laboratorike për të gjitha njësitë e KPS-ve sipas listave në shtojcat e udhëzimit administrativ është raportuar për 2 prej 12 njësite, me performancë prej 16.67%. Nivelin e pajtueshmërisë të me raportin e synuar 1 ekip e mjekësisë familjare për 2000 banorë komuna e Vitisë arrin në shkallë të lartë me rezultat prej 89.91%, duke ofruar 22 ekipe të mjekësisë familjare. Shkalla e përfshirjes së fëmijëve në program të imunizimit është e lartë, dhe është performancë e kënaqshme në kuptimin e gjithëpërfshirjes absolute, me 98.71% apo 3,299 fëmijë nga 3,342 fëmijë sa janë në program të imunizimit.

Fusha 19. Zhvillimi Ekonomik Lokal

Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 60.62%. Plani për zhvillim ekonomik lokal është raportuar si i realizuar, me performancë prej 100%. Komuna ka azhurnuar më tepër së 20% objekteve nga regjistri i objekteve për tatim në pronë, dhe për këtë arsye performanca kalon 100%. Nivelin e inkasimit të tatimit në pronë ka regjistruar shkallë mesatare të përmbushjes, duke ju referuar vlerave të raportuara të faturimit dhe inkasimit me € 385,623.27 dhe € 163,778.38 apo performancë prej 42.47%.

Shtojca 1: % e treguesve të performancës


SHËRBIMET ADMINISTRATIVE	1.1.1	Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit	
	1.1.2	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	99.97
	1.1.4	Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna	99.97
	2.1.1	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt online	70.00
TRANSPARENCA KOMUNALE	2.1.2	Niveli i qasje në dokumente publike nga qytetarët	100.00
	2.1.3	Përmbyshja e kritereve të faqes zyrtare elektronike të komunës	98.25
	2.1.4	Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal, në faqën zyrtare të komunës	87.50
	2.1.5	Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqën zyrtare të komunës	100.00
	2.2.1	Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit	100.00
	2.2.2	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik dhe i kontratave	100.00
	3.1.1	Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike	80.00
	3.1.2	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	100.00
	3.1.3	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	42.53
	3.1.4	Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal	100.00
PËRGJEGJSHMËRIA KOMUNALE	3.1.5	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	100.00
	3.1.6	Këshillat lokal që kanë mbajtur së paku 6 takime në vit	100.00
	3.1.7	Intervenimet për mbledhje të mbeturinave nga raportimet e qytetarëve	0.00
	3.1.8	Intervenimet në shpërthimet në ujëra të zeza	92.31
	3.2.1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	100.00
	3.2.2	Diskutime për raportet buxhetore tre-mujore nga Kuvendi Komunal	100.00
	3.2.3	Diskutim për raportin e performancës komunale nga kuvendi komunal për vitin paraprak	70.00
	3.2.4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Asamblenë	100.00
	3.2.5	Diskutimi i raportit të auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit në Asamblenë Komunale	0.00
	3.2.6	Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	50.00
	3.3.1	Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	0.00
	3.3.2	Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve	69.23
			59.83
			85.91

	3.3.3	Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit	37.50
	3.4.1	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal	100.00
	3.4.2	Suspendimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre	100.00
	3.5.1	Zbatimi i skemës për shpërndarjen e vlerësimeve të punës për shërbyesit civil	76.84
	3.5.2	Vende të hapura të punës që janë procesuar përmes SIMBNJ	100.00
	3.5.3	Kontratat për shërbime të veçanta janë në pajtueshmëri me kornizën ligjore	100.00
	4.1.1	Të punësuar me nevojë të veçanta në institucione komunale	0.00
	4.1.2	Të punësuar nga komunitetet jo-shumicë	59.38
	4.2.1	Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi dhe janë krijuar kushtet për lëshim të banimit social	80.00
	4.2.2	Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar	100.00
	5.1.1	Hapësira për aktivitete sportive për numër të banorëve	87.05
